



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:004467
Datë: 02.04.2024
Numri i dokumentit: 05531926

PKR.nr.7/2011

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtaret Mentor Hajraj kryetar, Fatos Sejdiqaj dhe Vlerona Maliqi anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Kaltrina Sfarqa, dhe zyrtaren ligjore Arijana Bislimi, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.P, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë PP.nr.148/2010 të datës 31.01.2011, për shkak të veprës penale: Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore me datë 07.02.2024 dhe 12.03.2024, të cila kanë qenë të hapura për publikun, në të cilat kanë prezantuar prokurorja e shtetit Fetije Bajrami, e dëmtuara E.P, i akuzuari B.P dhe mbrojtësja e tij av.Fatmire Braha, me datë 15.03.2024, ka marrë dhe publikisht në prezencën e të akuzuarit dhe mbrojtëses së tij ka shpallur, ndërsa me datë 02.04.2024, ka përpiluar me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit: B.P, me nofkën “.....”, nga i ati I..., e ëma Sh....., e vajzërisë Xh....., i lindur me datë... , në fshatin, komuna Vushtrri, ku edhe tani jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike.

SHPALLET FAJTOR

Sepse: Me dt.30.11.2010 rreth orës 11:00 në fsh.....-....., me dashje ka tentuar që të privoj nga jeta të dëmtuaren E.P për shkak se ka menduar se e dëmtuara po i bënë sehire (magji) në atë mënyrë që gjersa e dëmtuara ka qenë në WC i pandehuri ka hap me dhunë derën e WC dhe e ka goditur me thikë një herë në gjoks ku e dëmtuara ka filluar që të mbrohet duke i ngritur duart

lartë dhe me dorën e djathtë është munduar t'ia kap thikën që të mos e godas me c'rast i janë prerë gishtat e dorës së djathtë kurse me dorën e majtë e dëmtuara i ka veshur rrobat, pastaj ka arrit që të dal nga WC ku vajza e të dëmtuarës G..... e ka parë ngjarjen nga dritarja e shtëpisë dhe ka dalë e ka shtyrë të pandehurin dhe e ka larguar.

Me këtë ka kryer veprën penale: Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së.

Gjykata konstaton se veprën e lartcekur penale i akuzuari B.P e ka kryer në gjendje të aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 6, 11, 15, 34, 38, 64, 66 par.1 pika 1, dhe 67 par.1 pika 1.2 të KPK-së, lidhur me nenin 449, 452, 462 dhe 364 të KPP-së, i

SHQIPTON

-DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej një (1) vjet, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

-Të akuzuarit koha e kaluar në masën e paraburgimit prej datës 30.11.2010 deri me datë 19.01.2011, dhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej datës 19.01.2011 deri me datë 24.03.2011, i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

Në mbështetje të nenit 18 par.2 dhe nenit 86 par.1, nënpar.1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së, e lidhur me nenin 507 dhe 515 të KPP-së, të pandehurit Gjykata i :

SHQIPTON

Masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri

- Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri do të zgjasë për aq kohë sa është e nevojshme për trajtimin e të akuzuarit, por jo më gjatë se tre (3) vjet.

-Masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri do të ekzekutohet në Klinikën e Psikiatrisë në Prishtinë.

- I akuzuari duhet të paraqitet tek ky institucion pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

-I akuzuari obligohet që t'i nënshtrohet trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe të paraqitet në këtë institucion sipas kohës, terminëve dhe rekomandimit të mjekëve, gjithashtu të përdorë terapinë sipas rekomandimit të ekspertëve të kësaj qendre.

-Klinika e Psikiatrisë në Prishtinë, obligohet ta pranojë në trajtim të pandehurin sipas këtij Aktgjykimi si dhe t'i dërgoi gjykatës, raport me shkrim mbi gjendjen shëndetësore dhe suksesin e trajtimit për të akuzuarin, si dhe obligohet t'i raportoj gjykatës së paku një (1) herë në gjashtë (6) muaj, dhe të njoftojë gjykatën për çdo vështirësi në trajtim.

-I akuzuari paralajmërohet se në rast mosrespektimit të kësaj mase të shqiptuar, në rast se nuk merre pjesë në trajtim, refuzon apo kanoset që të kryejë ndonjë veprë tjetër penale, në këto raste Gjykata sipas detyrës zyrtare ose sipas propozimit të institucionit (Klinikës së Psikiatrisë në Prishtinë), do të zëvendësojë këtë masë në masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim.

-Në bazë të nenit 276 par.1 të KPPK-se, gjykata nga i akuzuari e konfiskon në mënyrë të përhershme thikën e cila është përdorur për kryerjen e veprës penale, e cila pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë do të asgjësohet nga Policia e Kosovës.

-Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe atë në emër të ekspertizës së shëndetit mendor të paguaj shumen prej 300 (treqindë) euro, në emër të ekspertizës së mjekësisë ligjore shumën prej 150 (njëqindë e pesëdhjetë) euro, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 (njëzet) euro dhe në emër të Kompensimit të viktimave të krimit obligohet të paguajë shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

-Pala e dëmtuar E.P, për realizimin e kërkesës pasurore–juridike lidhur me këtë çështje penale, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Aktakuza:

Prokuroria Publike e Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën PP.nr.148/2010 të datës 31.01.2011, kundër të akuzuarit B.P, për shkak të veprës penale: Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së.

Rrjedha e procedurës:

Gjykata ne këtë çështje penale ka mbajtur dy shqyrtime gjyqësore 07.02.2024 dhe me datë 12.03.2024, ndërsa shpalljen e aktgjykimit e ka bërë me datë 15.03.2024, në prezencën e të akuzuarit dhe mbrojtëses së tij.

Në këtë çështje penale i akuzuari ka qenë i përfaqësuar nga mbrojtësja sipas autorizimit av.Fatmire Braha.

Në shqyrtimin gjyqësore të datës 07.02.2024 ka prezantuar edhe e dëmtuara E.P.

I akuzuari është deklaruar i pafajshëm për kryerjen e veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së.

Provat e administruara në shqyrtimet gjyqësore:

Gjykata me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike në këtë çështje penale, ka administruar provat e propozuara në aktakuzë nga Prokuroria, ka dëgjuar në cilësinë e dëshmitares të dëmtuaren E.P, është lexuar procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitaren G.P në polici, me numër 2010-BD-1104, të datës 30.11.2010, është dëgjuar eksperti i psikiatrie forenzike Dr.Arsim Gashi, pastaj ka administruar edhe provat materiale si; Raporti i policit Oktaj Mejzini #5670, Raporti mjekësor i datës 30.11.2010 në emër të të dëmtuares E.P, Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve-thikës nga i pandehuri i datës 30.11.2010, Foto-albumi që gjendet në shkresat e lëndës, Akt ekspertimi mjeko-ligjor në emër të dëmtuarës E.P i datës 20.11.2023, Ekspertiza mbi gjendjen e shëndetit mendor të të pandehurit B.P të datës 10.10.2023.

Gjykata duke u bazuar në nenin 335 të KPP-së, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12.03.2024, sic u cek edhe me lart ka lexuar procesverbalin e marrjes në pyetje për dëshmitaren G.P në polici, me numër 2010-BD-1104, të datës 30.11.2010, pasi që për të njejtën gjykata i është drejtuar me kërkesë për sigurimin e adresës Policisë së Kosovës, mirëpo me datë 07.02.2024 nga Policia e Kosovës jemi njoftuar se dëshmitarja G.P gjendet jashtë vendit në

shtetin e Gjermanisë, e duke qenë se sigurimi i prezencës së të njejtës në seancë ishte i pamundur, gjykata si provë lexoi procesverbalin e marrjes në pyetje në polici.

Fjala përfundimtare e palëve:

-Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar; se mbetet pranë aktakuzës së ngritur ndaj të pandehurit B.P për veprën penale të cekur si në aktakuzë. Se i pandehuri ka kryer veprën penale vërtetohet edhe nga deklarata e të dëmtuares E.P, po ashtu edhe nga vet deklarata e të pandehurit e dhënë në prokurori, i cili ka deklaruar se atë ditë ka pasur një brisk për molla dhe e dëmtuara ka qenë në wc dhe ka pranuar se e ka godite me shuplakë mirëpo nga deklarata e të dëmtuares dhe nga raporti mjekësor vërtetohet se e njëjta është lënduar nga thika të cilën e ka përdorur i pandehuri me ç'rast e dëmtuara ka pësuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin. Po ashtu ka deklaruar se në dokumentacionin e shkresave të lëndës shihet vendi ku është kryer vepra penale gjë që e vërtetojnë pa mëdyshje se i pandehuri e ka kryer veprën penale, ndërsa nga ekspertiza e shëndetit mendor është vërtetuar se i pandehuri në kohën e kryerjes së veprës penale ka vuajtur nga një çrregullim i sëmundjeve mendor që kodohet me shifren F22. Gjykatës i ka propozuar që duke marr parasysh të gjitha këto prova të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'i merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, e po ashtu ka propozuar që të pandehurit t'i shqiptohet masa e trajtimit psikiatrik në liri.

-Mbrojtësja e të akuzuarit B.P av.Fatmire Braha, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor u vërtetua se i akuzuari B.P nuk ka kryer veprën penale të kualifikuar nga ana e prokurorisë Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, pasi që nga ekspertiza e psikiatrisë forenzike e datës 08.11.2023 u vërtetua se i akuzuari në kohën kur ka shkaktuar lëndimin e lehtë trupor të dëmtuares ka qenë apo ka pasur çrregullime të përhershme apo ka qenë me përgjegjësi të zvogëluar në shkallë esenciale. Po ashtu ka deklaruar se nga akt ekspertimi mjeko-ligjor i datës 20.11.2023, u vërtetua se e dëmtuara ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe me pasoja të përkohshme shëndetësore, si dhe nga deklarimi i të dëmtuarës në shqyrtimin gjyqësor të datës 07.02.2024, u vërtetua se veprimet e ndërmarra nga i akuzuari kanë qenë veprime si pasojë e çrregullimeve shëndetësore. E njëjta ka deklaruar se si mbrojtje konsideron se ka elemente të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, gjykatës i ka propozuar që të bëjë rikualifikimin e veprës penale bazuar në provat e administruara, e për të cilën vepër ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, gjykatës i ka propozuar që të hedhet aktakuza për shkak të parashkrimit absolut. Gjithashtu gjykatës i ka propozuar që në rast të mos rikualifikimit të veprës penale të merr parasysh akt ekspertimin mjeko-ligjor, ekspertizën e

eksperteve nga forenzika e psikiatrisë, kohën që nga kryerja e veprës penale që kanë kaluar mbi 13 vite, që i akuzuari asnjëherë gjatë kësaj kohe nuk ka rënë në kundërshtim me ligjin, faktin që është familjar dhe ka raporte shumë të mira me të dëmtuaren, gjendjen e tij shëndetësore dhe emocionale. Mbrojtësja ka propozuar që të akuzuarit t'i shqiptohet masa e trajtimit psikiatrik në liri dhe një dënim me të cilin nuk do të pengohet rrjedha e jetës së tij normale.

-I akuzuari B.P në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohet në tërësi me fjalën përfundimtare të mbrojtëses së tij.

Deklarimi i dëshmitareve:

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 07.02.2024, në cilësinë e dëshmitares është dëgjuar e dëmtuara E.P, e cila në dëshminë e saj ndër tjera deklaroi se derisa ajo ishte në wc, i akuzuari e ka hapur derën dhe e ka goditur me thikë dy herë në gjoks. Dëshmitarja ka deklaruar se në ato momente ka ardhur vajza e saj G..... e cila ka qenë mbrenda në shtëpi i ka dëgjuar britmat dhe së bashku me bashkëshorten e të akuzuarit kanë ardhur dhe e kanë larguar të akuzuarin. E njëjta ka deklaruar se pas kësaj e kanë dërguar në shtëpinë e shëndetit në Vushtrri dhe pas mjekimit të njejtën ditë është liruar.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12.03.2024, është lexuar procesverbali i marrjes në pyetje për dëshmitaren G.P në polici, me numër 2010-BD-1104, të datës 30.11.2010, ku e njëjta ka deklaruar se "...e kam dëgjuar nënën time E..... duke bërë titur me zë të lartë dhe duke më thirrur në emër o G.... , unë menjëherë kam dalur jashtë në oborr dhe kam parë nënën time që ishte ulur në tualet, ndërsa axhën tim B..... e kam parë duke e sulmuar nënën time me një dorë me grusht, ku pasi që jam afruar e kam vërejtur se asaj i rrjedhte gjake nga dora e djathtë. Në ato momente unë e kam shtyrë axhën tim B..... dhe e kam larguar nga nëna, kurse nënën e kam marr dhe e kam dërguar në shtëpi në dhomë, pasi që hymë brenda nëna më tha se më është lagur gjoksi pasi që e kishte marr një plagë nga goditjet e axhës B..... Ai me siguri ka pasur për qëllim që ta mbysë nënën pasi që kur kam vrapuar në drejtim të nënës e kam dëgjuar duke i thënë nënës kam me të mbytur krejt.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12.03.2024, është dëgjuar eksperti i psikiatrisë forenzike Dr.Arsim Gashi, i cili ndër të tjera lidhur me shëndetin mendor të akuzuarit ka deklaruar se duke u bazuar në të dhënat amnestike, shqyrtimin e shkresave të lëndës, dokumentacionit të kaluar mjekësor, është konstatuar se në kohën e kryerjes së veprës penale për

të cilën i ekzaminuari akuzohet i njëjti ka vuajtur nga çrregullimi deluzional dhe si rezultat aftësia e tij mendore për të kuptuar pasojat e veprimeve të veta ka qenë e zvogëluar në shkallën esenciale. I njëjti ka deklaruar se çrregullimi deluzional nga i cili vuan i ekzaminuari ka natyrë të përhershme, ecuria e manifestimit të simptomave delusinale varet nga ecuria e trajtimit të tij dhe faktoret e jashtëm. Deluzionet janë bindje apo mendime të gabuara për të cilat përkundër ofrimit të të gjitha fakteve të mundshme për të kundërtën, personi vazhdon të beson në ato mendime, ky çrregullim sipas klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve kodohet me shifrën F22.

Po ashtu ka deklaruar se në bazë të shkresave të lëndës, dokumentacionit mjekësor që e kemi poseduar, si dhe atyre të sjellura nga familjarët kemi kuptuar se i njëjti ka histori të trajtimit psikiatrik para dhe pas kryerjes së veprës për të cilën akuzohet. Në pyetjen e prokurores së shtetit se a ka qenë i rrezikshëm për shoqërinë, familjen në bazë të atyre raporteve, eksperti është përgjigjur se “me vete faktin se i njëjti ka kryer një vepër penale atëherë ka paraqit rrezik për shoqërinë”. Ndërsa në pyetjen e kryetarit të trupit gjykues se duke marr parasysh përgjigjen e mëhershme ku deklaruar se çrregullimi nga i cili vuan i pandehuri është i përhershëm, tani i pandehuri nëse ndodhet në liri a paraqet rrezik për veten, familjen dhe rrethin ku jeton, eksperti është përgjigjur “në bazë të vlerësimit aktual të gjendjes, shqyrtimit të rrjedhes së trajtimit të B..., ne mendojmë se nëse B... është i rregullt në trajnimin sipas dinamikës së mjekut të vet, vazhdon kjo gjendje e përmirësimit dhe nuk paraqet rrezik për veten apo për rrethin ku jeton, për këtë arsye kemi rekomanduar edhe masën e trajtimit psikiatrik në liri në klinikën e psikiatrisë në Prishtinë ku edhe ka qenë duke u trajtuar deri më tani”.

Provat materiale:

Siç u theksua edhe më lartë në këtë aktgjykim, gjykata në shqyrtim gjyqësor ka administruar provat materiale të cilat prokuroria i ka propozuar në aktakuzë si:

-Raportin e policit Oktaj Mejzini #5670, nga i cili u konstatua se me datë 30.11.2010, Njësia Patrolluese rreth orës 12:20 nga baza janë njoftuar që të shkojnë në fshatin Shtitaricë pasi ankuesja G.P e kishte lajmëruar rastin, të njëjtit kanë arritur në vend ngjarje në ora 12:25, kanë kontaktuar me G.P e cila i ka njoftuar se axha i saj B.P e ka therur me thikë nënën e saj E.P, kanë kontaktuar me të dëmtuarën dhe pas kësaj së bashku me të dëmtuaren dhe vajzën e saj janë nisur për në emergjencë.

-Raportin mjekësor të datës 30.11.2010, në emër të të dëmtuarës E.P, nga i cili u konstatua se e dëmtuara E.P ka pësuar plagë therëse 2+2cm, në pjesën e gjoksit nga ana e majtë dhe një plagë prerëse në gishtin e djathtë tregues dhe se lëndimet janë të lehta.

-Vërtetimin mbi konfiskimin e sendeve-thikës nga i pandehuri, i datës 30.11.2010, nga i cili vërtetim u konstatua se me datë 30.11.2010, nga i akuzuari B.P është konfiskuar një thikë e metalët me gjatësi totale 20cm, vetëm tehu me gjatësi 0.9cm.

-Fotoalbumi që gjendet në shkresat e lëndës, në të cilat fotografi shihet fotografimi i përgjigjshëm i vendit të ngjarjes, WC-ja në të cilën ka nodhur rasti, vetura e të akzuarit, thika me të cilën është kryer vepra, si dhe e dëmtuara E.P e gjakosur ne gjoks.

Sipas propozimit të mbrojtëses se të pandehurit, gjykata ka urdheruar që në këtë çështje penale për të pandehurin të bëhet ekzaminimi psikiatrik dhe në bazë të dokumentacioneve mjekësore të të dëmtuarës të nxjerrret ekspertizë e mjekësis ligjore.

Andaj gjykata në shqyrtim gjyqësor si prova materiale administroj edhe;

-Akt ekspertimi mjeko-ligjor në emër të të dëmtuarës E.P, i datës 20.11.2023,dhe Ekspertiza mbi gjendjen e shëndetit mendor të të pandehurit B.P e datës 10.10.2023.

Paraqitja e mbrojtjes nga i akuzuari:

I akuzuari B.P në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 12.03.2024, ka shfrytëzuar të drejtën që të mbrohet në heshtje, duke shtuar se mbetet pranë deklaratimit të dhënë në Prokurorinë e Qarkut në Mitrovicë me datë 14.01.2011.

Në Prokurorinë e Qarkut në Mitrovicë, tani Prokuroria Themelore në Mitrovicë, i akuzuari ka dhënë deklaratë me datë 14.01.2011, ka deklaruar se “unë kurfarë mendimi të keq nuk kam patur ndaj të dëmtuarës dhe nuk di as vet se si më ndodhi ky rast. Nuk e di as vet se si më ka ardh ai moment dhe unë e di që e kam pasur një brisk për molla dhe e dëmtuara ka qenë jashtë wc, unë ia kam hi një shuplak, ka ardh vajza e saj G..... e më ka shty dhe më ka thënë a je normal, unë pas kësaj kam hy brenda në shtëpi dhe jam dal menjëherë e kam marr automjetin tim dhe jam nis për me shku për në Vushtrri për me ju drejtu policisë për gabimin që e kam bërë dhe mua policia më kanë arrestuar te pompa e benzines në dalje të Vushtrrisë. Në një shtëpi jetojmë me

vëllaun A..... , i kemi nga dy dhoma secili, hyrjen në shtëpi e kemi të përbashkët, po ashtu banjon dhe tualetin. Për këtë të keqe nuk kam pas kurfarë qëllimi dhe nuk e di as vet se si më ka ndodh... Nuk kam pas kurfarë qëllimi me e mbyt”.

Në policinë e Kosovës me datë 01.12.2010, i akuzuari ka deklaruar se nuk është në gjendje shëndetësore që të japë deklaratë, ashtu që ka shfrytëzuar të drejtën që të mbrohet në heshtje.

Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet:

-Është fakt jokontestues se vendi ku është zhvilluar ngjarja me datë 30.11.2010, ka qenë në fshatin , komuna Vushtrri, në shtëpinë e përbashkët të akuzuarit dhe të dëmtuarës.

-Është fakt jokontestues se i akuzuari të dëmtuarën e ka bashkeshorte të vëllait, ky fakt është konstatuar nga deklarimi i palëve.

-Është jokontestues fakti se i akuzuari dhe e dëmtuara si dhe familjet e tyre edhe më herët kanë pasur probleme të natyrave të ndryshme mes tyre, ky fakt është konstatuar edhe nga deklarimi i dëshmitares G.P i dhënë në polici, me datë 30.11.2010.

-Është jokontestues fakti se thika me të cilën është therur e dëmtuara, ka qenë e të pandehurit B.P, ky fakt është konstatuar edhe nga vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve-thikës nga i pandehuri, i datës 30.11.2010.

-Është jokontestues fakti se e dëmtuara ka pësuar plagë prerëse në anën e majtë të krahorit dhe në gishtin e dytë të dorës së djathtë, të shkaktuara nga veprimi i mjetit të fortë dhe të mprehtë të cilat bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore dhe me pasoja të përkohshme shëndetësore, ky fakt është konstatuar nga akt ekspertimi mjeko-ligjor në emër të dëmtuarës E.P, i datës 20.11.2023.

-Është fakt jokontestues se i akuzuari vuan nga çrregullimi deluzional që në klasifikimin ndërkombëtar të sëmundjeve kodohet me shifrën F22, dhe se në momentin e kryerjes së veprës për të cilën akuzohet aftësia për të kontrolluar veprimet e veta ka qenë e zvogëluar në shkallë esenciale, ky fakt është konstatuar nga ekspertiza mbi gjendjen e shëndetit mendor të të pandehurit B.P e datës 10.10.2023, si dhe nga dëgjimi i ekspertit Dr.Arsim Gashi në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12.03.2024.

Vlerësimi i provave nga Gjykata:

Gjykata ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike duke u bazuar në provat e administruara në shqyrtimet gjyqësore si dëshmitë e të dëmtuares-dëshmitares E.P, deklarimi i dëshmitares G.P në polici më 30.11.2010, dëgjimi i ekspertit Dr.Arsim Gashi në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12.03.2024, pastaj nga provat materiale Raporti i policit Oktaj Mejzini #5670, Raporti mjekësor i datës 30.11.2010 në emër të të dëmtuares E.P, Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve-thikës nga i pandehuri i datës 30.11.2010, Foto-albumi që gjendet në shkresat e lëndës, Akt ekspertimi mjeko-ligjor në emër të dëmtuarës E.P i datës 20.11.2023, Ekspertiza mbi gjendjen e shëndetit mendor të të pandehurit B.P të datës 10.10.2023.

-Nga deklarata e të dëmtuarës E.P e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 07.02.2024, rezulton se derisa e dëmtuara-dëshmitarja ishte në wc, i akuzuari e ka hapur derën dhe e ka goditur me thikë një herë në gjoks dhe derisa e demtuara ishte duke i mbrojtur e ka prer gishtine ne thiken te cilen e kishte i akzuar, dhe se në ato momente ka ardhur vajza e të dëmtuarës G..... e cila ka qenë brenda në shtëpi i ka dëgjuar britmat dhe së bashku me bashkëshorten e të akuzuarit kanë ardhur dhe e kanë larguar të akuzuarin. Pas kësaj e kanë dërguar të dëmtuarën në shtëpinë e shëndetit në Vushtri dhe pas mjekimit të njejtën ditë është liruar.

-Nga deklarimi i dëshmitares G.P në polici më 30.11.2010, rezulton se e njëjta e ka dëgjuar të dëmtuarën-nënë e saj duke bërëtitur dhe kur ka dalur jashtë në oborr e ka parë axhën-të akuzuarin duke e sulmuar të dëmtuarën dhe se në ato momente e ka shtyrë të akuzuarin dhe e ka larguar nga e dëmtuara, kurse të dëmtuarën e ka marr dhe e ka dërguar brenda në shtëpi.

-Nga deklarimi i ekspertit te psikiatrize forenzike Dr.Arsim Gashi, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 12.03.2024, rezulton se çrregullimi nga i cili vuan i akuzuari është çrregullim delusional, i karakterit psikotik, ka ecuri kronike, natyrë të përhershme dhe manifestohet me periudha të zbehjes së deluzioneve, deluzionet janë bindje apo mendime të gabuara për të cilat përkundër ofrimit të të gjitha fakteve të mundshme për të kundërtën, personi vazhdon të beson në ato mendime, ky çrregullim sipas klasifikimit ndërkombëtar të sëmundjeve kodohet me shifrën F22. Eksperti ka konstatuar se në kohën e kryerjes së veprës penale për të cilën akuzohet i njëjti ka vuajtur nga çrregullimi deluzional dhe si rezultat aftësia e tij mendore për të kuptuar pasojat e veprimeve të veta ka qenë e zvogëluar në shkallën esenciale.

-Nga ekspertiza mbi gjendjen e shëndetit mendor të të pandehurit B.P të datës 10.10.2023, u vertetua se i akuzuari vuan nga çrregullimi deluzional që në klasifikimin ndërkombëtar të

sëmundjeve kodohet me shifrën F22, që manifestohet me dëmtime të theksuara në të menduar, aspektin emocional dhe social dhe se në momentin e kryerjes së veprës për të cilën akuzohet aftësia për të kontrolluar veprimet e veta ka qenë e zvogëluar në shkallë esenciale.

-Nga akt ekspertimi mjeko-ligjor i datës 20.11.2023, vërtetohet fakti se e dëmtuara ka pësuar lëndime trupore dhe ate lëndime të cilat paraqesin plagë të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë dhe të mprehtë anën e majtë të krahrorit dhe në gishtin e dytë të dorës së djathtë dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me pasoja të përkohshme shëndetësore.

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi, analizoje dhe krahasoje mes vete të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor dhe faktin se i akuzuari ditën kritike ka tentuar që të privojë nga jeta të dëmtuarën e vërtetohet dhe u bazua në dëshmitë e dëshmitarëve-të dëmtuarës E.P, deklaramit të dëshmitares G.P në Polici, pastaj në provat materiale si: Raporti i policit Oktaj Mejzini #5670, Raporti mjekësor i datës 30.11.2010 në emër të të dëmtuarës E.P, Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve-thikës nga i pandehuri i datës 30.11.2010, Foto-albumi që gjendet në shkresat e lëndës. Nga te cilat prova u vërtetua se i akuzuari me datë 30.11.2010, në fshatin Shtitaricë, komuna Vushtrri, ka tentuar që të privojë nga jeta të dëmtuarën në atë mënyrë që të dëmtuarën e ka goditur në gjoks me thikë dhe në gishtin e dytë të dorës së djathtë, duke i shkaktuar lëndime trupore të konstatuara si në akt ekspertimin mjeko-ligjor.

Nga të gjitha provat e administruara në shqyrtimet gjyqësore, rrjedh se tek i akuzuari ditën kritike ekzistonte dashja që të dëmtuarën të privojë nga jeta, pasi që i njëjti ka ndërmarr veprime të caktuara me qëllim që të dëmtuarën t'a privojë nga jeta, pasi që të njëjtën e ka goditur me thike me tehun e gjatesise 9 cm, në anën e majtë të krahrorit, në pjesë vitale të trupit, si pasojë e të cilit veprim të dëmtuarës i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe të përkohshme. Pra, nga rrethanat faktike nxjerrët dashja e të akuzuarit, që në rastin konkret ka qenë privimi nga jeta e të dëmtuarës dhe si rrjedhojë u vërtetua përtej çdo dyshimi se i akuzuari B.P ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së. Per me teper kjo rrethane vertetohet edhe nga deklarimi i deshmitares G.P, e cila e ka larguar te akuzarin nga e demtuara dhe ka degjuar te akuzuarin duke i thene te demtuares “se kam me te mbyte krejt”. Andaj bazuar ne te gjitha keto rrethana gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor per kryerjen e vepres penale sipas aktakuzes, dhe i shqiptojë dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Pretendimet e palëve:

Gjykata vlerësoi pretendimet e palëve të shprehura në shqyrtim gjyqësor, siç ishin pretendimet e mbrojtëses dhe pretendimet e të akuzuarit.

-Pretendimet e mbrojtëses të akuzuarit por edhe të akuzuarit ishin se veprimet e ndërmarra nga i akuzuari kanë qenë veprime si pasojë e çrregullimeve shëndetësore dhe se ka elemente të veprës penale Lëndim i lehtë trupor, ashtu që gjykatës i ka propozuar rikualifikimin e veprës penale.

Gjykata vlerëson se pretendim se në rastin konkret ka elemente të veprës penale të lëndimit të lehtë trupor, është i pa argumentuara dhe i pa qëndrueshëm, pavarësisht asaj se nga ekspertiza mjeko ligjore janë konstatuar lëndime të lehta trupore të cilat i ka pësuar e demtuara, pasi që në rastin konkret nga administrimi i të gjitha provave në shqyrtim gjyqësor është vërtetuar se dashja e të akuzuarit ka qenë që të dëmtuarën t'a privojë nga jeta duke marrë parasysh faktin se të njejtën e ka goditur me thike me tehun e gjatësisë 9 cm, në anën e majtë të krahorit, në pjesë vitale të trupit, pra nga rrethanat faktike nxjerrët dashja e të akuzuarit, që në rastin konkret ka qenë privimi nga jeta e të dëmtuarës dhe si rrjedhojë u vërtetua përtej çdo dyshimi se i akuzuari B.P ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së. Për më tepër kjo rrethanë vërtetohet edhe nga deklarimi i deshmëtarës G.P, e cila e ka larguar të akuzuarin nga e demtuara dhe ka degjuar të akuzuarin duke i thënë të deshmëtarës “se kam me të mbyte krejt”.

Ndërsa sa i përket pretendimit se veprimet e ndërmarra nga i akuzuari kanë qenë veprime si pasojë e çrregullimeve shëndetësore të aspektit mendor, nga shkresat e lëndës perkatesisht nga ekspertiza e shëndetit mendor për të akuzuarin, por edhe nga deklarimi i ekspertit të psikiatrie forenzike në shqyrtim gjyqësor u vërtetua se i akuzuari vuan nga çrregullimi deluzional që në klasifikimin ndërkombëtar të sëmundjeve kodohet me shifrën F22, që manifestohet me dëmtime të theksuara në të menduar, aspektin emocional dhe social dhe se në momentin e kryerjes së veprës për të cilën akuzohet aftësia për të kontrolluar veprimet e veta ka qenë e zvogëluar në shkallë esenciale.

Gjykata konstaton se personi i cili ka kryer veprën penale konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar natyrën dhe rëndësinë apo pasojën e veprimeve ose mosveprimeve të tij ka qenë esencialisht e zvogëluar për shkak se në kohën e kryerjes së veprës penale lëngonte nga një sëmundje mendore e përkohshme ose e përhershme, nëse kishte çrregullim mendor apo ngecje në zhvillimin mendor që e ka prekur

funksionimin e tij, mirepo personi i tillë konsiderohet penalisht përgjegjës, por këto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos për kohëzgjatjen dhe llojin e sanksionit ose masës së trajtimit të detyrueshëm.

Ne rastin konkret pasi që u konstatua se tek i akuzuari në momentin e kryerjes së veprës për të cilën akuzohet, aftësia për të kontrolluar veprimet e veta ka qenë e zvogëluar në shkallë esenciale, gjykata këtu rrethane e pati parasysh kur vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dhe krahas denimit kryesor të akuzuarit i shqiptojë edhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik nga liria.

Andaj, gjykata edhe një herë rithekson se pas administrimit të të gjitha provave në shqyrtim gjyqësor dhe pas analizimit të secilës prej tyre veç e veç dhe si tërësi, është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet e veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, pasi që përtej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari me datë 30.11.2010, në fshatin , komuna Vushtrri, ka tentuar që të privojë nga jeta të dëmtuarën në atë mënyrë që të dëmtuarën e ka goditur me thikë me teh me gjatësi prej 9cm në gjoks, ashtu që e dëmtuara ka pësuar lëndime trupore dhe atë lëndime të cilat paraqesin plagë të shkaktuara nga veprimi metalik i mjetit të fortë dhe të mprehtë në anën e majtë të krahorit dhe në gishtin e dytë të dorës së djathtë dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me pasoja të përkohshme shëndetësore, për çka gjykata të akuzuarin e ka shpallur fajtor për kryerjen e kësaj veprë penale dhe i ka shqiptuar dënimin si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Shqiptimi i masës së trajtimit të detyruar psikiatrik nga liria:

Gjykata, duke u bazuar në ekspertizën mbi gjendjen e shëndetit mendor të të pandehurit B.P të datës 10.10.2023, ka vërtetuar se i pandehuri B.P, veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, e ka kryer në gjendje të aftësisë së zvogëluar esenciale mendore, ngase ai vuan nga çrregullimi mendor i cili sipas klasifikimit ndërkombëtar mendor të sëmundjeve kodohet me shifrën F22, e që nuk e përjashton përgjegjshmërinë.

Gjykata, faktet e lartëcekura i ka vërtetuar nga deklarimet e ekspertit të psikiatrisë Dr.Arsim Gashi, dhënë në shqyrtim gjyqësor si dhe raporti i ekspertizës psikiatrike i lëshuar nga Instituti i Psikiatrisë Forenzike në Kosovë – Prishtinë. Gjykata, i ka fal besimin e plotë mendimit të ekspertit të psikiatrisë Dr.Arsim Gashi në seancë gjyqësore si dhe ekspertizës psikiatrike, kjo për arsye se i pandehuri i është nënshtruar ekzaminimit të plotë për një kohë në IPFK, ekspertiza

është bërë nga një grup i ekspertëve multidiciplinar dhe në një institucion publik, kredibil dhe kompetente për këtë fushë.

Gjykata, duke u bazuar në ekspertizën e Institutit të Psikiatrisë Forezike të Kosovë, ka vërtetuar se i pandehuri B.P në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë në gjendje të përgjegjësishë esencialisht të zvogëluar për t'i kuptuar dhe kontrolluar veprimet e tij, shkaku i një çrregullimi mendor që në klasifikimin ndërkombëtar të sëmundjeve kodohet me F22.

Gjykata, ka vendosur që t'i shqiptoi të pandehurit masën e trajtimit të detyruar psikiatrik në liri, pasi që ka vërtetuar dhe konstatuar se i pandehuri B.P veprën penale të cekur si më lartë për të cilën është shpallur fajtor, e ka kryer në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore, kjo për faktin se nga mendimi i ekspertëve i paraqitur në ekspertizën e psikiatrisë së Institutit të Psikiatrisë Forezike të Kosovës në Prishtinë si dhe nga mendimi i ekspertit të psikiatrisë Dr.Arsim Gashi, dhënë në shqyrtim gjyqësor është vërtetuar se i pandehuri vuan nga një çrregullim mendor i klasifikuar në listën ndërkombëtare të sëmundjeve F22, prandaj nga ekspertet është propozuar dhe rekomanduar që ndaj të pandehurit, të shqiptohet masa e trajtimit të detyruar psikiatrik në liri, meqenëse i pandehuri nëse përdorë rregullisht terapinë e përshkruar nuk paraqet rrezik për veten e as për mjedisin.

Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për veprën penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, pastaj pati parasysh edhe qëllimin e dënimit dhe të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në ashpërsimin ose zbutjen e dënimit.

Si rrethanë lehtësuese gjeti rrethanat e tij personale, se i njëjti është familjar, pastaj si rrethanë lehtësuese nga gjykata u vlerësua fakti se i akuzuari më herët nuk ka kryer veprë tjetër penale ngase pas verifikimit në Gjykatën Themelore në Mitrovicë sipas sistemit të data bazës së SQEP i njëjti nuk ka lëndë me aktgjykim të formës së prerë, ndërkaq rrethanë rënduese, gjykata gjeti intensitetin e dëmtimit përkatësisht vlerës së mbrojtur, ku e dëmtuara ishte goditur nga i pandehuri me thikë në pjesë vitale të trupit, dhe si rezultat ka pësuar lëndim trupore.

Në rastin konkret kundër këtij të akuzuari gjykata vendosi ne baze te nenit 66 par.1 pika 1.1. te KPK-se, që të aplikojë dispozitat e zbutjes së dënimit dhe të njëjtit i shqiptojë dënimin me burgim

si në dispozitiv të aktgjykimit nën minimumin e paraparë ligjore për veprë penale: Vrasje në tentativ nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, pasi që kryerja e veprës penale nga i akuzuari ka mbetur në tentativë dhe sipas nenit 20 të KPK-së, personi që tenton të kryej veprë penale dënohet sikur të kishte kryer veprën penale, *por dënimi mund të zbutet*, pra ligji e parashih mundësinë e zbutjes së dënimit. Në rastin konkret për këtë veprë penale gjykata të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin me burgim prej 1 (një) viti.

Gjykata vendosi që ndaj të akuzuarit të shqiptojë dënimin me burgim nën minimumin e paraparë ligjore e meqenëse në nenin 67 të KPK-se, kufijtë e zbutjes së dënimit nuk ishin përcaktuar në mënyrë specifike kur denueshmeria ishte prej se paku 5 vite, gjykata në përputhje me nenin 3 të KPP-se, duke u bazuar në parimin *In dubio pro reo* paragrafi 2 detyron gjykatën se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penale interpretohet në favor të të pandehurit, dhe meqë nuk kishte kufijtë specifik të zbutjes kur si minimum i dënimit ishte paraparë dënimi me 5 vite burgim, në kontekst të kësaj dispozite e duke qenë baza ligjore për aplikimin e zbutjes së dënimit gjykata ka aplikuar nenin 67 par.1 në par.2, për kundër se në këtë paragraf si masë e dënimit me burgim ishte dënimi prej 3 vjetëve, por të gjitha këto duke i interpretuar në kontekst të rrethanave dhe fakteve të rëndësishme për çështjen ka interpretuar në favor të të pandehurit.

Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale me të cilën akuzohet i pandehuri dhe se Gjykata ka vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllim i dënimit i paraparë me nenin 34 të KPK-së, se i pandehuri në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e paligjshme dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale.

Të akuzuarit, gjykata në bazë të nenit 73 par.1 të KPK-së, kohën e kaluar në masën e paraburgimit prej datës 30.11.2010 deri me datë 19.01.2011 dhe kohën e kaluar në masën e arrestit shtëpiak prej datës 19.01.2011 deri me datë 24.03.2011, i'a ka llogaritur në dënimin e shqiptuar me burgim.

Konfiskimi:

Në bazë të nenit 276 par.1 të KPP-së, gjykata nga i akuzuari e konfiskon në mënyrë të përhershme thikën, e cila pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë do të shkatërrohet nga Policia e Kosovës.

Shpenzimet e procedurës penale:

Gjykata e ka detyruar të akuzuarin që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të ekspertizës së shëndetit mendor dhe prezantimit të ekspertit të psikiatrisë forenzike në shqyrtimin gjyqësor të paguaj shumen prej 300 (treqindë) euro, në emër të ekspertizës së mjekësisë ligjore shumën prej 150 (njëqindë e pesëdhjetë) euro, në emër te paushallit gjyqësor shumën prej 20 (njëzet) euro dhe në emër te Kompensimit të viktimave të krimit obligohet të paguajë shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, duke u mbështetur në nenin 449 dhe 452 të KPP-së, ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit në mbështetje të nenit 36 par.3 nën par.3.2 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesa pasurore juridike:

Vendimin për udhëzimin e palës të dëmtuar që kërkesën pasurore juridike t'a realizojë në kontest të rregullt civil, gjykata e mori në bazë të nenit 462 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Gjykata, nga arsyet e cekura si më lartë, bazuar në dispozitën ligjore nga neni 364 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.7/2011, datë 02.04.2024

Zyrtarja ligjore
Arijana Bislimi

Kryetari i trupit gjykues
Mentor Hajraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa, i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.

Numri i lëndës: 2020:004467
Datë: 02.04.2024
Numri i dokumentit: 05531926